

Të shtëna me armë zjarri në Kaçanik- 35 vjeçari shoqërohet në stacion policor



05/05/2025 08:49

f

t

s

Të shtëna me armë zjarri raportohet të ketë pasur mbrëmë në fshatin Begrac të Kaçanikut.

Policia e Kosovës ka njoftuar se zyrtarët policorë gjatë patrullimit në këtë fshat kanë dëgjuar të shtëna armësh nga një aheng familjar.

Në vendngjarje është identifikuar personi F. S., 35 vjeç, i cili ka pranuar se kishte shtënë me armë zjarri, të cilën e kishte me leje.

Me këtë rast, policia ka njoftuat se arma është konfiskuar (pa municion) kurse i dyshuari është shoqëruar në stacionin policor për intervistim nga njësia e hetimeve.

Lidhur me rastin është njoftuar prokurori i shtetit, i cili ka udhëzuar të iniciohet rasti për veprën penale "Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm". Pas intervistimit, personi është liruar, ndërsa rasti do të procedohet në mënyrë të rregullt./Lajmi.net/



Më shumë nga uebi

Pas kufizimit të alkoolit, Gani Gërmia

Reader Favorites: Top 25 Recipes from 2023

Butrinti trondit show bizzin, e bën publike

Horoskopi DITOR, E ENJTE 25 Prill 2024

Vritet në luftë ish-përfaqësuesi rus i

nativeGRAM

by LuponMedia

Artikuj të ngjashëm

May 5, 2025
Vodhi pesë vëç në një stallë të Kaçanikut, arrestohet 39-vjeçari

lajmi.net

info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Gr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr.

RRJETET SOCIALE

f

@

t

y

Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information

©Copyright Lajmi.net 2022. All Rights Reserved

Privacy Policy